ADEM ZAPLLUZHA

MES TELAVE GJEMBOR

Redaktor:
Remzi Limani

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Veli Veliu

ADEM ZAPLLUZHA

MES TELAVE GJEMBOR

"TREND"
2015

Fjala e redaktorit

VJERSHËRIMET E BUZËQESHJEVE TË HUMBURA

Kur mendja jonë merr rrugë nëpër udhët me shkronja, na bëhet i pashmangshëm kapërcimi nëpër shtegun e hapur të krijimtarisë letrare të poetit tonë. Adem Zaplluzha. Ky krijues, me një opus të gjerë e të lakmuar në fushën e poezisë moderne, me nostalgji dhe pezëm, nëpërmjet metaforës së qartë poetike na shfleton narracionin figurativ nëpër të cilin kalojnë fatet e njeriut nëpër kohë dhe hapësira të ndryshme. Duke e kërkuar arsyen e humbur, nëpër poezitë e tij, poeti Zaplluzha, deri në kubenë e qiellit ngre zërin e këngës së vrarë, për ta kuptuar dhe hetuar dhembjen e njeriut, i cili sikur mbeti i ndryrë në katrorin e mugëtirës së pafrymë, e një kohej njerkë, kohë e cila na bëhet e shurdhër në të dy guaskat e veshëve të prishur dhe nuk e dëgjojnë dot vajin e këngës ngushëlluese për njeriun dhe buzëqeshjen e tij të humbur. Pra, në librin **"Mes telave gjembor",** të ndarë në tri cikle, poeti në mes ëndrrash, me nostalgji i këndon fëmijërisë së humbur */Shtëpia e jonë kurrë nuk ishte e zbrazët/Më kujtohet kur na mungonin lodrat/Por ajo mbushej me dashuri/*. Pastaj, në dy ciklet tjera na jep një pasqyrim lucid të një shtrese sociale njerëzish me halle…, të nëpërkëmbur dhe të anashkaluar nga syri

dhe mendja e shoqërisë në fron. Pra, vjershërimet e veshura me petkun e dhimbjes u kushtohen njerëzve të tulatur nga frika e mendjes së tyre dhe vetmia e pashpirt, të cilëve, pa dëshirën e tyre, gjithandej u loz mendja e shkretë…! */Ajo i ngërmohej edhe mushkonjave/Që ia bezdisnin mendjen e humbur/*

Këtu, pra, poeti në fjalë, thotë qartazi, se dhembja e kësaj shtrese shoqërore është dhembja jonë. Ne jemi ata dhe ata janë pasqyrimi ynë. Në këtë kontekst, karshi ndërgjegjes sonë të humbur, poeti vishet me dhembjen e njerëzve të cilët i takojnë vetvetes sonë. Prandaj, me të drejtë dhe me pezëm, poeti ynë derdhë ofshamën e kohës ngufatësh , që nuk na jep frymën e duhur për t`i kapërcyer dhimbjet dhe regëtimat e kohës së zbehur, e cila na është bërë dritë e pakët – ndoshta më e pakët se një llambë vajguri…!

Në këtë përmbledhje fjalësh e ofshamash nëpër kohë, autori i librit **"Mes telave gjembor"** bën strukturimin e duhur të fjalëve dhe ndërtimin e poezisë e vendos mbi bazat e qëndrueshmërisë faktike siç e përshkruan autori në poezinë e tij /*Njëri që i kishte kaluar të tetëdhjetat/Kujtimet i mbante në dorën e djathtë/Një qeskë najloni e tejdukshme/Mbushur me flokë të thinjura/Mbase donte t`i djeg të gjitha trishtimet/.* Pra, nga dhembja e njerëzve të anashkaluar, poeti nxjerrë në pah mungesën e ndërgjegjes sonë, humanizmit dhe njerëzisë që nuk e kemi karshi të tjerëve. Andaj, kjo lloj poezie, na vjen edhe si vërejtje shoqërore, që më në fund, vishemi me njerëzoren, të kandisemi dhe të

veprojmë në përputhje me normat dhe ligjet mbi të drejtat e njeriut.

Si shumë njerëz, të cilët patën fat të ecën qirithi nëpër kohë..., edhe poetin Zaplluzha, koha e veshi me petkun e një moshë të kaluar mbi shtatëdhjetë kalendarë të zhubrosur dhe të harruar nëpër mote. Mirëpo, mosha e tij kalendarike nuk vërehej as në sy e as në shtrëngim duarsh. Pra, këtë vitalitet fizik e mendorë, këtë "pangopësi" për të shkruar e shkruar..., Zaplluzha sikur e fiton nga fjalët e gatuara dhe gjumin e shtrirë mbi shtratin e mbushur me shkronja shqipe dhe ëndrra fjalësh... Ai nuk ndalon së shkruari as për një frymë njeriu. Koha e Adem Zaplluzhës vazhdon me rrjedhën e lumit dhe të fjalës shqipe. Kur dita, paksa e lodhur në kocka kërrusej, pahetueshëm hëna kacavirrej në dritaren dhomës së tij. Tani, po ashtu pahetueshëm; dita mbuzej me natën dhe takohen në udhëkryqin e fjalëve ende të pa thëna...

Remzi Limani
Prishtinë, 6 qershor 2014

Nëse më premton koha
cikli i parë

GJITHNJË DUKEN NË LËVIZJE

Nga këndvështrim im
Gjërat asnjëherë nuk i ndryshojnë format
Në dukje të parë janë të ngurta
Por nga brendia e tyre
Pikojnë disa lloje të eliksireve
Që janë të tejdukshëm
Si frymëmarrja në shishen e kristaltë

Edhe njerëzit janë të tillë
Kur bie shi
Ecin me zbrazëtinë e tyre
Gjatë tërë jetës bashkëjetojnë me intrigat
Dhe në fund të parathënies
Nuk mbërrin askund

Gjithnjë duken në lëvizje
Dhe asnjëherë nuk mund të kuptojnë
Se janë duke vendnumëruar
Në ndonjë ekspozitë të imagjinuar
Vendnumërojnë si ushtarët prej dylli

Ditëve të diela kapen për disa gjëra
Që i përngjajnë thashethemeve
Rrallë herë shikimet i hedhin
Mbi flokët e thinjura të kambanës
Dhe i thërrasin në ndihmë
Ëndrrat e së kaluarës

KUR NUK KA MUNGUAR DASHURIA

Kur isha fëmijë
Shtëpia e jonë kurrë nuk ishte e zbrazët
Më kujtohet fare mirë
Kur na mungonin lodrat
Por ajo përherë mbushej me dashuri

Ishte si një ambient
I stërmbushur me përplot përralla
Kur sytë e motrës sime
Mbusheshin me lot
Rënkonte edhe çatia e mbuluar me kashtë

Asgjë këtu nuk ndodhte rastësisht
Të befasishme ishin
Vetëm ardhjet e mysafirëve
Në ato çaste
Si shpirti mikpritës i nënës sime
Hapeshin krah më krah portat

Në shtëpinë tonë nuk ishin të radhë mysafirët
Ata vinin çdo herë ditën e tretë të javës
Sepse të mërkurave
Ishte dhe është ditë tregu në Prizren

Nënëlokja herët në mëngjes
I hapte dyert
Sepse në shtëpinë tonë
Edhe kur mungonte buka jonë e përditshme
Kurrë nuk na ka munguar dashuria

NËSE MË PREMTON KOHA

Sa herë që bie në gjumë
I thërras ëndrrat
I thërras
Të mos jem i vetëm
Si çdo njeri edhe unë kam nevojë
Të fshihem pas dikujt

Një ditë
Do t'i grumbulloj të gjitha përrallat
Po ashtu edhe ëndrrat
Që sa herë të kam nevojë
Për ndonjë aventurë
Të dal rrugëve me imagjinatën time

S'do t'i lë anash as zogjtë
Kam nevojë më besoni
Kam shumë nevojë të mësoj
Sekretin e fluturimit

Dua që hapësira e kaltër
Të jetë e imja
Si sytë e kaltër të detit
Nëse më premton koha
Një ditë do të dal nga lëkura ime
Të shndërrohem në zog të kaltër qielli

ASNJËHERË NUK PATA KOHË

Do shkoj në mal
Të mësoj prej gjetheve
Mjeshtërinë e frymëmarrjes

Po ju them
Do të dal një ditë në ndonjë pyll
Të bëjë diçka për vetveten time
Asnjëherë nuk pata kohë
Të bisedoj me gjethet në gjelbërim

S'do të marr me vete asgjë
Nuk më duhet asnjë pikë uji
Kur më zë etja
Do e shuaj me pikëzat e para të vesës

Asgjë tjetër nuk do të kem
Në trastën time
Përpos një gllënjkë dashurie për atdheun
E cila me shekuj po rënkon

NË QENIEN E NJERIUT

Thonë se në çdo vend
Ka nga një vend të braktisur
Unë pohoj të kundërtën
Në qenien e njeriut
Asnjëherë nuk mund t'i gjesh
Limanet e boshatisura të kujtesës

ATO JANË NË GJENDJE

Mes grave të bukura
Ka edhe gra më të pashme
Ato me flok prej mjegulle
Nga qerpikët majë gjilpëre
Pikojnë yjet inkandeshente

Gra flutura të trilluara prej ëndrrave
Që jetojnë mes burrave zjarr
Ato janë në gatishmëri
Ta shtrydhin edhe diellin
Vetëm të posedojnë
Një copë të madhe dashurie në shpirt

Gra me zemër hëne
Që netëve të vona butësisht
I ledhatojnë ëndrrat e përgjumura
Gra që nuk i përngjajnë grave
Janë aq të bukura
Sa që edhe djallin e ngujojnë në shishe

QË I PËRNGJAJNË DASHURISË

Po që se të gjithë ne
Do të dukemi një ditë
Pakëz më ndryshe
E jo kështu siç jemi sot

Por t'i ngjajmë
Disa krijesave paqësore
Që i përngjajnë dashurisë
Nuk di si do të dukeshim atëherë

Pastaj edhe avionët prej duralumini
Në vend se të gjuajnë me bomba
Do të ishte befasia më e mirë
T'i gjuajnë njerëzit me do lule dafine

HERË JANË TË ËMBLA E HERË PELIN

Sa shumë i ngjajnë ditët
Njëra - tjetrës
Në këtë qytet nuk dihet
Kur është e hënë
E kur e diel dhe kujtimet
Ulen mbi kryqe
Prej fijeve të kujtesës

Dita e djeshme
Është si ajo e sotmja
Pa frymëmarrje të mirëfilltë
E nesërmja nuk ka as një dallim
Prej ditës që do të vij
Në një tjetër nesër

Edhe njerëzit janë të tillë
Ngjajnë si ditët
Njëra me tjetrën
Ngjajnë
Si kokrrat e kumbullave
Herë janë të ëmbla
E herë pelin si ditët që rrokullisen
Tej përroit të djajve

PËR ÇATINË E MADHE TË ATDHEUT

Mbi njëqind vjet
I kam ruajtur këto ëndrra për ju
Kam bredhur si somnambul
Udhëve të botës
Me etjen dhe urinë time
Me shpresa të vdekura
I kam mbajtur gjallë trishtimet e mia

Kam shëtitur nëpër tërë dynjanë
Kudo që isha
Ato i fshihja me xhelozi
Në damarët e gjakut tim
Njëherë i pata fshehur
Si hartën e atdheut
Në ashtin e djathtë të dorës sime

I fshihja nga çdo njeri
Sepse kanë qenë të ruajtura
Vetëm për ju
Dhe fëmijët e juaj
Ëndrrat e mia ishin si ëndrrat
E të gjithëve
Ëndrra shumë të vogla
Për çatinë e madhe të atdheut

THINISHT BUZËQESHTE ARDHACAKU

Kurrë nuk kam qenë vetjak
Mua më mjafton të kam një pikë ujë
Pak bukë dhe një kokërr krip nën gjuhë
Dhe të më vije një buzëqeshje e virgjër

Kur na e grabitën shtëpinë
Nuk di athua vallë dënesa
Apo buzëqesha atë ditë
Por një ndryshim i jashtëzakonshëm
Ndodhi në shpirtin tim

Më kujtohet ajo kohë me suferinë
Nga pak reshte edhe borë
Vjeshta i numëronte ditët e fundit
Kurse ne hymë në një dimër të ashpër

Kur ju thash se kurrë nuk isha vetjak
Mbase ju mashtrova
Prej ditës së grabitjes
Ndryshoi buzëqeshja ime
Në vend se të buzëqeshja unë
Thinisht buzëqeshte ardhacaku i çmendur

MBRËMË ISHIM SHUMË LARG

Mbrëmë ishim shumë larg njëri - tjetrit
Ti në shtratin tënd me pupla zogjsh
Kurse unë prajshëm bisedoja
Me një zog të trishtuar
Dhe me kovën e urinimit

E di mirë
Ti kishe me miliona dëshira
Kurse unë vetëm një gjë të vockël
Më mungonte një supë e ngrohtë
Dhe gota e kristaltë
Me qumësht të nxehtë

Më mungonte hidhërimi yt
Si frymëmarrja më mungoje ti
Çfarë t'i them vetmisë së verbët
Kur në këtë birucë të pshurrtë
Edhe ajri i ndotur kundërmon urinë

Mbrëmë ishim shumë larg
Njëri - tjetrit
Unë me ëndrrat e mia
Kurse ti me të tuat
Njëmijë vjet larg njëri - tjetrit
Në cilën gjuhë ta përkthej
Vetmin time
E cila po më ngufat në heshtje

KURSE DIMRIT PLAKEN

Secila stinë ka nga një pamje më ndryshe
Ecën me kokë nën sqetull
Me nga një maskë të verbër
Në fytyrë

Vjeshta nuk ngjanë asnjë stine
As dimri me pranverën
Në vjeshtë njerëzit martohen
Kurse në dimër plaken drurët

Në pranverë dhe verë
Njerëzit nuk kanë kohë për asgjë
Si zogjtë shtegtarë
Largohen kah jugu
Kanë përmallim të flaktë
Për serenatat e guaskave

NJË DITË KANË AROMË TOKE

Të kam thënë
Se çasteve të humbura
Kurrë nuk do t'i besojmë
Të kujtohet kur bisedonim
Për dashurinë e njerëzve
Dhe vdekjen e drurëve

Ishte një kohë e mjegullt
Zogjtë e egër
Nuk mund të gjenin asnjë pemë
Ku mund të flinin
Kurse netët e pagjumë
Janë të gjata

Të kam thënë
Se gratë e dashuruara u përngjajnë lumenjve
Herë fryhen e herë shfryhen
Një ditë kanë aromë toke
Kurse ditën tjetër
I përngjajnë hënës lakuriqe

KUSH DO T'I ÇELË SONTE PORTAT E FJALËVE

Udhët tona janë të ndryshkura
Edhe dryni i kohës
Kush do t'i çelë sonte portat e fjalëve
Ky shi i trentë dhe rrjedha e tij
Paska hyrë në parathëniet e librave
Dhe po qanë si fëmijë

Me muaj të tërë janë duke pritur
Në lima gratë e peshkatarëve
Asnjë varkë e humbur nuk kthehet
Pasqyra e trishtuar
Për herë të parë paska mbetur sonte
Në pellgun e mendimeve

Një korb krakëllin në shi
Mbase ka dhembje
Mbi kryqin e sterrës rrinë bubullimat
Kambana strukur në gjumin e ikonës
I numëron të dielat e dështuara

UNË NUK NJOH GHUHË TË HUAJA

Më duket se kot jam lutur deri më sot
Përfundimisht heq dorë
Prej perëndive
Mua nuk me deshën kurrë
Ndoshta
As unë nuk e desha vetveten
Në çastet më vendimtare
Të gjithëve ua ktheva shpinën

Ua ktheve shpinën
Sepse kurrë nuk ishin me mua
Asnjë Perëndi nuk më ndihmonte
As paganët
Nuk vijnë më në qytetin tim
Nuk vijnë sepse nuk kanë për kë

Andaj nuk më ka mbetur
Se kujt t'i lutem
Në cilën gjuhë të flas me qiellin
Mu kanë përzier Zotat
Unë nuk njoh gjuhë të huaja
Kurse gjuha ime shqipe
Nuk po u intereson Perëndive

ISHTE NJË SERENATË ARKAIKE

U deshën ndoshta njëmijë vjet
Deri te çasti i duhur
Ne ishim vetëm të vetmuar
Kur u bashkuam
E kaluara u harrua
Iku diku mes grunajave
U fsheh me kallinjtë e zhuritur të korrikut

Ishte një ditë e mbushur me premtime
Kali im i egër
Egërsisht hingëllonte
Një copë e verdhë mjegulle
Na bënte hije mbi kokat tona të shfrenuara
Bënte hije si të ishim Perëndi

Të kujtohet
Dikur vonë kur dielli iku pas maleve
Unë këndoja nën dritaren tënde
Ashtu pa lidhje këndoja
Sepse as që kam ditur të këndojë

Ishte një serenatë arkaike
Unë këndoja pa lidhje
Kurse ti nuk i ndalje të qeshurat
Atë çast qeshe deri në mëngjes

ASKSUH NUK GJENDET NË DHOMË

Askush nuk gjendet në dhomë
Përpos këmbëve të mia
Një çorapë
S'di e cilës këmbë është
Po kundërmon si kungulli i kalbur

Nuk di se ku më mbeti çorapi
I këmbës tjetër
Po të ishte në dhomë
Do të iknin edhe librat

Me mua po zgërdhihet
Një pikturë surrealiste
Nga muri përballë raftit me libra
Paskan ikur ikonat
Vetëm këmbët e mia të djersitura
Shkelin mbi qilim të vjetër

Askush në këtë dhomë
Përpos çorapëve
Era i lanë sytë e sklepave
Çorapi i këmbës së djathtë proteston
Ashpër proteston
Edhe dritarja e mbyllur

NJERËZIT NUK BLEJNË ASGJË

Në qytet nuk paska mbetur asnjë tregim
Mbi kryqin e erës së acartë
Rri ulur dashuria
Rri ulur dhe mediton si Buda

Secili prej nesh
Pret nga diçka të paqartë
Një njeri me pallto të zezë
Vrapon pas këpucëve të hirta që ikin
Nëpër vitrinat e boshatisura
Nuk ka mbetur as një lloj malli
Shitësit e gazetave
Janë shndërruar në një tren gënjeshtrash

Njerëzit nuk blejnë asgjë
Sepse nuk kanë se çfarë për të shitur
Një rrap i vjetër
I mbështetet bastunit të erës

Plepi i bardhë e fut dorën
Në zgërbonjën e selvisë
Nxjerrë shaminë prej letre
Dhe rrugëve ua fshinë hundët

ERA ZGËRDHIHEJ ME SHIRINGAT

Sot për sot
I kam kryer detyrat e shtëpisë
Duke blerë gazetën
Një qen endacak urinoi mbi këpucët e mia

Era zgërdhihej me shiringat
Që dikush i ka harruar
Mbi stolin e vjetër të parkut të ri
Miku im
Një i krishterë i moshuar
Deri në fyt ishte fundosur në borxhe

Hoxha nga minarja lajmëron
Vdekjen e një tregtari
I shkreti
Pasi bankrotimit
Kishte bërë vetëvrasje

Qyteti ende përkundet në gjumë
Degët e mështeknës
I përshëndesin kalimtarët e rastit
Nga furra "Agroni"
Shqisat kapin aromën e bukëve të pjekura
Herët në menatë
Furrtari i paska kryer detyrat e shtëpisë

QENI

Pas dyzetë e ca vjetëve
Kur u ktheva në shtëpi
Trokita frikshëm
Hyra brenda
Pash një qen të thinjur

Nuk e njoha
Më njohu ai mua
Mu afrua ngadalë
Duke më shikuar drejtë në sy
M'i urinoi këpucët

Prishtinë, 14 maj 2014

BLEJNË SPINAQ BAJAT

Në mëhallën time të ngushtë
Jetojnë njerëz të rëndomtë
Secili e këqyrë punën e vetë
Ato të huajat nuk u interesojnë

Dalin në treg me një shpresë
Se do gjejnë zarzavate
Me çmim më të lirë
Nuk u intereson aq shumë kualiteti

Buxheti nuk lejon të zgjedhin
Blejnë spinaq bajat
Të shtrirë nëpër ditët e kaluara
Nuk kanë gajle për humbjen e vitaminave

Ushqimi më i afërt për ta
Janë brumërat e shtëpisë
Të gatuara nga zonjat e tyre
Dhe pohojnë se standardin e kanë pite

NËPËR ËNDRRA MJEGULLNAJASH

Në duart e mëdha të diellit
Është strukur hëna
Dhe duket e thyer
Si një drapër i ndryshkur
Për herë të parë yjet kundrojnë
Këtë pamje surrealiste

Meteorët me bisht ngarendin
Hapësirës së paanë
Po afrohet një sterrë e trishtë
Mbase eklipsi
I ka lëshuar rrjetat pasosura
Për ta zënë ngushtë hapësirën

Një tjetër diell ka zënë
E po buron si një ujëvarë
E stërzgjatur
Nëpër ëndrra mjegullnajash
Dhe nga qerpikët e galaktikave
Të pazbuluara ende
Shtrydh mendimet e çasteve të boshatisura

Mes telave gjembor
Cikli i dytë

MË SHUMË BISEDOJNË ME VETVETEN

Atyre që u është mjegulluar koka
As pantallonat e shfrenuara
Nuk u rrinë në trup
Përngjajnë me spitalet
Ku asnjëherë
Nuk shërohen njerëzit

Kanë shikime të turbullta
Skizofrenia bashkëjeton
Me këmishët e arnuara
Që nuk lahen me muaj të tërë
Në hidhërim e sipër
Urinojnë këmbët e njëri - tjetrit

Këta njerëz flokëshprishur
Më shumë bisedojnë në heshtje
Me vetveten
Dhe për vetveten e tyre
Se sa me ndonjë mjek klandestin

Kështu vite me radhë ata presin
Të ndryshken kangjellat
Që t'i lëshojnë këmishët e bardha
Të hynë diku fshehurazi
Nëpër rrugët e pamundësisë
Së një jetë të shpërfillur

NË FYTYRAT E ZVERDHURA TË DRURËVE

Këtu njerëzit rrinë ulur nën hijet e blirëve
Rrinë me nga një zog në kokë
Sa herë që shikojnë qiellin
Glasat bien si shiu
Në fytyrat e zverdhura të drurëve

Pacientët me ca këmisha të shthurura
Janë mjeshtrit më të përsosur
Të mimikës së vuajtjeve
Në çdo kohë ushtrojnë pantomimën
Bisedojnë me gishtat e nxirë të nikotinës

Asnjë copë gazete
As ato të grimcuara prej minjve
Nuk i gjuajnë
I fshehin nën jastëkët e palarë
Që të nesërmen të mbështjellin
Ndonjë cigare kaçaku

Nuk lënë letër mbi tokë
Nëpër xhepat e tyre
Kanë disa lloje letrash të vjetra
Prej atyre të dashurisë
Deri te recetat e ilaçeve
Që përdoren këtu për të sëmurit psikik

TRAJTAT E TË GJITHA PIKAVE TË SHIUT

Një zonjë e moshuar
Me një shosh të vjetër
I grumbullonte në një kazan bakri
Trajtat e të gjitha pikave të shiut

Më pastaj i lidhte në nyje
I lidhte si kujtimet e adoleshencës
Nga fustani i saj i larmë
Kishin zbritur të gjitha zbukurimet

Në trupin e dërmuar e të shtrembëruar
Vizatohej një bardhësi e paparë
Pa asnjë ngjyrë tjetër
Dukej si një engjëll pa kurorë

Herë qeshte me vetveten
E herë i ngërmohej dikujt
Që nuk dukej askund
Në afërsinë e saj të trishtuar

Ajo i ngërmohej edhe mushkonjave
Që ia bezdisnin mendjen e humbur
Thinjat e këputura të erës
Ngërmoheshi me zërin e saj të ngathtë

PANTALLONAT E ARNUARA ME MALL

Në sheshin e telave me gjemba
Për çdo ditë e orë
I stivojnë fjalët e njëri - tjetrit
I stivojnë si drutë
Në kohën e inkuizicionit

Njëri që i kishte kaluar të tetëdhjetat
Kujtimet i mbante në dorën e djathtë
Një qeskë najloni e tejdukshme
Mbushur me flokë të thinjura
Mbase donte me i djeg të gjitha trishtimet

Secili prej banorëve të kësaj shtëpie
Kanë se çfarë të djegin
Këta njerëz janë në gjendje
Të bëjnë çdo gjë
Të djegin edhe dashurinë e tyre

Asgjë nuk iu dhimbset
I djegin thonjtë e fshehur
Qerpikët e thinjur prej shiringave
Pantallonat e arnuara me mall
Por një gjë kuptova këtu
Se sa me qejf i djegin
Këmishët e tyre të bardha
Me mëngë të lidhura pas shpine

SHIKON ASGJËNË NË HAPËSIRË

Sytë e saj
Ishin të mëdha si kokrra ulliri
Si dy dritare të errëta
Balluket e mëndafshta
Lëshoheshin tej belit të saj të brishtë

Sa të mëdhenj janë sytë
Kur i përngjajnë territ
Të një verbërie pa shpresë
Ecin rrugicave të ngushta
Si ushtarët prej dylli

Dy dete të shteruar
Shtrihen mbi ballin e thinjur
Ajo herë i largon sklepat
Me dorën e djathtë
E herë me dorën tjetër të sakatosur

Për çdo ditë në mbrëmje
Ulet në stolin pranë bredhit të zi
Dhe shikon errësirën e syve
Dhe të mendjes së tretur diku
Shikon asgjënë në hapësirë

2.

Shoqja e saj e dhomës
Mbanë në dorë
Një kukull të drunjtë
Veshur me leckat e fëmijërisë
Asaj i kujtohet
Dashuria e dylltë e një stine

Nga gjinjtë e saj prej rëre
Pikon një dhembje
Pikon heshtazi
E nuk pushon së pikuari
Malli për djepin

Që të dyja këto gra
Kanë se çfarë të përkundin
Njëra dritën
Kurse tjetra sterrën
Jetojnë duke përkundur
Amshimin e verbët

JANË TË MBYLLUR SI PAPAGAJTË

Njerëzit në këtë shtëpi të çmendurish
Janë krijesa pa ëndrra
Secili në gjumin e vet rënkon
Mbjellin kohën e ikur
Dhe korrë trishtimin e përditshmërisë

Bredhin brenda telave gjembor
Pa ndjerë barrën e asnjë faji
Në fytyrat e shumicës
Vërehen qeshjet e akullta të pranverës

Ndoshta edhe nuk dinë
Të qeshin me diellin
Sa herë që mërrolen
U përngjajnë mjegullave të hirta
Nga shpirtrat e tyre të vetmuar
Pikojnë tjetër lloj shirash

Janë njerëz pa shpresë
Pa asnjë ëndërr për jetën
Jetojnë brenda telave
Të mbyllur e të pa gojë
Jetojnë në botën e përhumbur
Nëpër dhomat e errëta të gjumit

KISHTE NJË FYTYRË ASNJANËSE

Si një kënde**s** i dehur rrinte
Mbi oxhakun e japisë
Kishte një fytyrë pak më ndryshe
Nuk ishte mashkull
Por ama s'ishte as femër

Qenie pa gjini
Nuk i përngjante as vetvetes
Kishte një pamje trekëndëshi
Edhe ashtu ndjehej
Kur këndonte mbi çati

Me një fshesë thuprash
Fshinte çdo gjë para tij
Zakonisht kur binte shi
Vetëm atëherë kjo qenie asnjanëse
I lante sytë e lëbyrtë
Në ullukët e ndryshkur të çatisë

I MJELË MJEGULLAT

Gjatë tërë jetës kacavirrej nëpër degë
Hante frytet e papjekura
Ky njeri veçantë
I përngjante ketrit

Nëpër zgërbonja lisash
Grumbullonte fryte
Kur binte borë
Kishte një frikë të paparë nga bardhësira

Asnjëherë nuk ndjente etje
I zgjate duart kah qielli
Mbase kështu më së miri
I mjelë mjegullat kur dalin në kullotë

JETOJNË ME MENDIME TË PËRZIERA

Njerëzit këtu jetojnë si mbretër
Nëpër imagjinatën e tyre
Flenë si në paradhomat e mbretërve
Gjumin e bëjnë në panteonin e mjegullave
Secili kollitet në fronin e tij
Dhe ndjehet Perëndi në vete

Njerëzit këtu
Jetojnë me mendime të shthurura
Sa herë që u teket
E pështynë qiellin

I kafshojnë fjalët e tyre
Dhe qeshin me lugët e palara
Janë zota të paprekshëm
Në panteonin e mendjes së ikur

Sa herë që prishet moti
E vijnë rrebeshe shirash
Lakuriqësitë i shpalosin në oborr
Dhe i lajnë mëkatet
Me papastërtitë e ditëve të kaluara
Atyre që kanë ikur
Dhe të atyre ditëve që do vijnë

Dalin nëpër rrugët e qytetit
Me nga një fener
Mbase mendojnë
Se edhe nëpër shëtitore
Mbisundon errësira e njëjtë
Si në kokat e qethura zero
Ëndërrojnë panteonin e tyre
Nëpër paradhomat e trishtimeve

OSE MBRËMJEVE TË VONA

Ngjanë që nga kjo shtëpi
E të sëmurëve psikik
Të dalin edhe arkivole të hirtë
Për befasinë e çdokujt
Këtyre njerëzve pa ndjenja
U mungojnë lotët
Mbase edhe nuk e njohin vajin

Me sy të hapur mështjerre
Dhe të mëdhenj si ullinjtë
I përcjellin arkivolet
Deri te portat e hapura të Ferrit

Një buzëqeshje e hidhur
Zvarritet nëpër sytë e tharë
Këta banorë
Bredhin prej një vendi
Deri në një ëndërr të pa definuar
Mbase nuk dinë as të qeshin
E as të qajnë

Si çdo ditë
Edhe ditëve të tjera
Luajnë me gjymtyrët e tyre
Një gruaje me lëkurë të rrjepur
Nga gishtat e kohës së ikur
I pikonte një lëng i bardhë

Si thasë hijesh
Të ngarkuara me mort
Për çdo mëngjes
Ose mbrëmjeve të vona
Defilojnë arkivolet pa kryq e nishan

ÇDO MËNGJES TAKOJ NJË NJERI ME SHPIRT TË GURTË

Mua nuk më duhet t'i lutem askujt
As ikonave të verbëta
Ky njeri që rri mbi këtë gur
S'di t'i lutet asnjë Perëndie

Çdo menatë e shoh
Rri aty si të ishte i penduar
Rri si një mi i lagur
Duke i fshehur shikimet
I përcjellë kalimtarët e rastit

Mos vallë
Do e takoj të dashurën
Një shi i sëmurë
Po i lag flokët dhe kujtimet e hidhura

Atë njeri me shpirt të gurtë
Për çdo mëngjes
E shoh të ulur mbi një gur të murrmë
Shoh kah i numëron hijet
Me gishtat e sëmur prej skeleti

DHE NGA STËRKALAT E SHIUT TË IMTË

Më thanë se ai njeri
Ishte i ngarkuar me mëkatet
Me dëshirat e tij të sëmura
Për çdo ditë
Ëndërronte pranverën lakuriqe

Sa herë që dilte në kopshtin e mollëve
Qonte dashuri me një dru
Që kishte filluar të thahej
I pëlqenin përqafimet e gjetheve të njoma

Nga rrënjët e drurit të zi
Pinte sisë dhe ëndërronte
Se si e mëkonte mëndesha e tij e vdekur
Kur kishte mbetur bonjak

Kur vinte dimri i acartë
E gjethet binin përtokë
Në dhomën e tij mbinte një tjetër dru
Me degë të thyera kajsie

Me padurim e prite pranverën
Kënaqej me gjethet surrealiste
Dhe nga stërkalat e shiut të imtë
Thurte poezi dashurie për nusen e ëndrrave

ASNJËHERË NUK VJEN DIELLI

Brenda këtyre telave gjemborë
Gjithmonë rri një dimër i varur
Acari fërshëllen serenata të trishtuara
Stinët e tjera mbështillen
Me fashat e papastra
Prej mëkateve

Në çdo kohë të ditës
Mbrëmjeve të vona
Kolliten muret e mykura
Nga tavanet shkundet myshku
Shkunden trishtimet
E shpirtrave të vdekur

Pranvera dhe vjeshta
Asnjëherë nuk kalojnë këndej pari
Gjithmonë është dimër
Edhe kur dielli i shkrinë
Gurtë nga vapa përcllues
Këtu sërish këndon acari

Brenda këtyre mureve
Me pasqyra të ndryshkura
Asnjëherë nuk vjen dielli
Mbase vetëm hijet
Kanë një forcë të çeliktë të mbijetesës

KËPUCËT KISHIN MARR UDHË

Vjeshta qante mbrëmë
Si një kitarë me tela të këputura
Dëgjohej edhe cijatja e lugëve
Në këtë paradhomë
Çdo gjë në këto çaste
Qenka shndërruar në vajë

S'pushojnë as muret e djersitura
Një vajë që ngjante
Me vajin e lejlekëve
Dëgjohej ofshama
Si një rënkim shpirti
Enët vallëzojnë nëpër kuzhinë
Një valle të vjetër morti

Nga dhomat e korridorit të pafund
Vinte një zë i ngjirur
Më duket se qanin edhe muret
Këpucët kishin marr udhë
Dhe ishin larguar diku
Për një kohë të papërcaktuar

QANTE MBI NJË DUNË PIKËLLIMI

Nën strehët e çatisë së rrënuar
Sonte po fshihen lakuriqët
Një grua e verdhë
Lozte me çarçafët e përgjakur

Nëpër dhomat e gjumit
Nuk dëgjohej as fluturimi i mizës
Në korridoret e gjata
S'kishte mbetur asnjë pacient
Nga ky trishtim
Kishin ikur edhe mjekët

Mështekna e dhunuar
Qante mbi një dunë pikëllimi
Era i shkulte flokët
E një peme të moshuar

Sonte pas ikjes së lakuriqëve
Zunë të dëgjohen
Disa lloje daullesh të shurdhëta
Sa me dhembje qante fyelli
Në korijet e djegura të kujtesës

PËRNGJANIN ME FËMIJËT E BRAKTISUR

Me qindra herë
Njerëzit këtu kanë pritur
Dhe përjetuar në sy
Zhveshjet e mëngjeseve
Hijet morbide
I dhunonin lagështit e mureve

Sa herë që kalova këndej pari
Në gjysmë shtizë të lëshuar
Dënesnin plepat
Edhe çezma e vjetër në oborr
Nuk e ndalte vajin

As kalldrëmet
S'ishin në gjendje më të mirë
Ollukët e çative
Përngjanin me fëmijët e braktisur
Sa herë që i shikoj
Shoh rrëke lotësh të kristalta
Edhe era qanë si mjellma e pikëlluar

Një njeri i ri
I lidhte në nyje degët e thyera
Të manit të zi
Lumi i shfryer mbrëmë i shembi urat
Askush më nuk guxoi
Të kapërcej matanë urës

PËR T'U TAKUAR ME JETËN E ZHVESHUR

Kur bie shi
Këtu njerëzit shëtisin nudo
Nëpër shëtitoret e zhveshura
Me dhe pa brekë
Vrapojnë trotuareve qentë endacak

Secili prej nesh
Shikojmë njëri-tjetrin
Me shikimet tona të bezdisshme
E zhveshim njeriun deri në asht
Dhe qeshim me vetveten

Kështu për çdo ditë
Shëtitorja e qytetit shndërrohet
Në një arenë lakuriqe
Ku defilojnë kuajt e verbër
Defilojnë me mëgojëza të sermta

Kur bie shi
Edhe mushkonjat fluturojnë lakuriqe
Era e zhveshur i mbathë sandalet
Dhe vrapon rrugëve
Vrapon deri në çmendi
Për t'u takuar me jetën e zhveshur
Mes këtyre telave gjembor

IKONAT KANË DAL NGA KORNIZAT

Pas të reshurave të pandalshme
Kopshtet në qytetin tim
Pikturojnë imazhet surrealiste

Drurët vrapojnë tavernave
Vrapojnë të dehen
Ndoshta për herë të fundit
Me lotët e dyshimtë të Perëndive

Era sjellë një freski nga malet
Ikonat kanë dalë nga kornizat
Dhe vallëzojnë në erë
Me shiun e çmendur të vjeshtës

SËRISH NGA IMAGJINATA E EPSHIT

Nëpër dyert e epshit
As nuk hapen
E as nuk mbyllen portat e Ferrit
Ti preke burimin e shiut
Në daç
Të krahasohesh me lotët e kitarës

Era dëneste mbrëmë
Dëneste si një fëmijë i braktisur
Mbi pastelet e sëmura të shiut
Një njëri i moshuar
Shkruante epitafin
E një tregimi arkaik

Sërish nga imagjinata e epshit
Zbritën shirat e vjeshtës
Lugët e palara në kuzhinë
Vallëzuan për herë të fundit
Vallen e përkryer të shiut

Më duket se ishte fundi i një përralle
Në rrugë dolën plakat e zhveshura
Një njeri i humbur
Mes fjalëve të erës
I kërkonte imazhet e një dite
Që u bë humbëtirë mbi dunat e pikëllimit

I PIMË GLLËNJKAT E FUNDIT TË SHIUT

Kush jam unë
Që më bëhet vonë ta kuptoj
Se çfarë dite është sot
Dhe çfarë duhet të jetë nesër

Këtu në këtë qytet të verbët
Njerëzit u mësuan me pantomimën
Secili prej nesh
Ka nga një mallkim për të nesërmen

Ecim rrugëve të përlotura
Pa i përfillur
Rregullat e komunikacionit
Në shumë raste u përngjajmë
Kuajve të paçjerrë

Jemi krijesa që shpërfillim
Çdo gjë çfarë vjen prej të tjerëve
Duam që gjërat të fillojnë nga ne
Kurse ne nuk jemi askund

Bredhim të dehur
Rrugëve të asfaltuara
I pimë gllënjkat e fundit të shiut
Vetëm se vetëm
Gjërat të fillojnë me ne
Dhe të mos përfundojnë
Askurrë pas nesh

PAS IKJES SË SHIRAVE

Vonë kuptova se këtu
Si tërkuzë samari
Zvarriten ditët e sëmura
Po ashtu edhe netët

Muret e verdha në çdo kohë ngushtohen
Kur bien gjethet
Stinët në këtë oborr mbesin të vetmuara
Si njerëzit e humbur

Nën pemët e fryra si lumenjtë
Tymosen gjymtyrët
Era këndej pari
Vjen vetë një herë në vjet

Kurse ditët në vijim
Kalërojnë
Vetëm pjesët e tjera
Të parëndësishme të gjymtyrëve

Pas ikjes së shirave
Kuptova se në këtë kopsht
Asnjëherë
Nuk erdhën Perënditë

Vetëm vallja e egër e djajve
Mund të shihej
Që vallëzonte me njerëzit e humbur
Me një aureolë në kokë

Kishte edhe njerëz të tjerë
Që iknin nga Olimpi i trishtimeve
Perënditë mbinin nëpër saksi
Si luleshpatat e egra

Prishtinë, 15 maj 2014

PËRNGJAJNË ME TRENAT E SHURDHËR

Vonë kuptova
Se këtu në majë shtizash
Ëndrrat çelin disa lloje lulesh
Për çdo ditë çelin
Fytyra të trishtuara prej dheu

Këta njerëz të humbur jetojnë
Me mendime somnambulësh
Nëpër çatitë e rrënuara
Ngjajnë me trenat e shurdhër
Që fërshëllejnë
Netëve të vona të kujtesës

Prej mëngjesit deri në mbrëmje
Herë i mbjellin pemët mbrapshtë
E herë i korrin të mbjellat pa u pjekur
Netëve të vona
Flasin me degët e thyera të pemëve

Nëpër flokët e tyre s'vrapojnë thinjat
Jetojnë prej një çasti
Në çastin tjetër
Të ditës së zbrazët
Duke i fshehur boshllëqet
Në fytyrën e padukshme të ironisë

PËR TË UA MARRË KËMBËT SI TROFE LUFTE

Mëngjeseve herët
Ulen mbi bankinat e rrugëve
Dhe si rosak të egër
I përcjellin me kureshtje
Përshëllimat e trenave
Ditët e tyre të zbrazëta
I kalojnë me një barrë të rënd

Pas çdo sjelljeje të tyre
Fshihet shpirt i shprishur
Qeshin me kalimtarët e rastit
Ose i ndjekin këndesat
Nëpër fermat më të afërta
Për të ua marrë këmbët si trofe lufte

Kur perëndon dielli i muzgut të mbrëmjes
Urtësohen si pulat
Dhe fshehurazi futen
Nëpër dhomat e tyre të fjetjes
Ku nëpër ullukët e netëve
Të ndryshkura
Mëngjeset i presin me përplot ankthe

Secili këtu bashkëjeton
Me vetveten
Dhe me hallet e veta
Disa janë shumë agresiv
Disa të tjerë
Ngjajnë me lepujt e trembur
Dhe tërë ditën e lume
Struken në shpirtrat e tyre të vetmuar

MES TELAVE GJEMBOR

Edhe ky qen i murrmë
Me telashet e njerëzve
Mes këtyre telave gjembor
Qenka plakur tej mase

Sa herë që i shkund shpatullat
Një nga një
I këputen thinjat
E qimeve në disa pjesë të pabarabarta

Nuk di a e sollën për dëfrim
Në këtë azil trishtimi
Mjekët në thonjëza
Që më së paku
Mendojnë për njerëzit

Ose dikush tjetër e solli këtu
Dhe mosha e tij prej qeni
E bëri të veten
Edhe lehjet e veta i ka harruar
Ky mik i ngushtë
I banorëve mes telave me gjemba

ASKUJT NUK I PENGONIN KËTO IMAZHE

Duke i shikuar trishtimet
Në sytë e këtyre njerëzve të hutuar
Ndjeva një dhembje të pa frymë
Në vend të pantallonave të arnuara
Një i moshuar
E kishte veshur këmishën
Dhe qeshte me një kënde**s** mbi pleh

Pas tij një kolonë qirinjsh të ndezur
Ishin drejtuar kah salla e ngrënies
Çinarët e thyer kundërmonin
Si lakrat e prishura nëpër thasë najloni
I gjithë ambienti i spitalit
Ishte shndërruar në det turshish

Por për çudi
Askujt nuk i pengonin këto imazhe
S'dinin as të mendonin
Duhej të shpejtonin
Sepse koha e ngrënies
Sa ora përfundon
Personat që vonohen
Duhet të presin mëngjesin e së nesërmes

SHKULIN DHEMBJEN E VESËS

Miqtë e mi këtu
Jetojnë pa psalme
Asnjëherë askujt nuk i luten
Përpos mureve
Të ngjyrosura me ngjyrë të zezë
Dhe lagështisë së erës së mykur

Ngjanë që nëpër këto murana
Si nëpër kunguj
T'i ngulin gozhdët e trishtimit
Dhe të nesërmen
Pa zbardhur agullima
Shkulin nga shpirtrat e drurëve
Tërë biografinë
E një jete të pa jetuar

Mëngjeseve kur zgjohen këndesat
Presin në rreshta të gjatë
Të urinojnë pas muranave
Dhe disa prej banorëve
Nga rrënjët e barit
shkulin dhembjen e vesës
Dhe thonë
Kështu më së miri pastrohen
Sklepat e syve të përgjumur

TA VËMË GISHTIN NË KOKË

Sa për fundin e këtij tregimi
Më duhet t'i them
Edhe dy fjalë
Por zor se do mundem
Më janë shtjelluar mendimet
Si kokat e këtyre banorëve të pafat

S'di as çfarë desha të them
Por dua të shtoj diçka
Pa marrë parasysh
Mos pafsha më kurrë në jetë
Imazhe kaq të trishtuara
Të shpirtrave të virgjër

Sa për fillimin
Dhe fundin e këtij tregimi
Është koha
Ta vëmë gishtin në kokë
Ta vëmë dhe të mendojmë esëll
Se çfarë ndjenja do të kishim
Po të ishin këtu
Nënat ose baballarët tanë

Trokite në shpirtin e drurit
Cikli i tretë

TI ISHE FJALA E PARË

Mendimet e mia e mbyllën gojën
Nuk më rrodhi asnjë fjalë
Mes dhëmbëve
Ti ishe fjala e parë
Dhe e fundit që pështpëriste era

Stinët disi strukeshin thellë
Nën flokët e sermta
Dhe kujtimeve të thinjura
Ne vraponim si kuajt e verbër
Vraponim
Pas parathënieve të erës

Kurrë nuk kuptova
Ose më mungonte koha
Për fjalët e ndërkryera të heshtjeve
Unë kisha një brengë tjetër
Në shuplakat e stinës
Na i vrisnin zogjtë

Dhe ja kështu i tëri mbeta
Si një përmendore e ngrirë
Mes kolonadave të mermerta
Koha ishte diçka e veçantë
Vendimtare në orët e vona të natës
Dasmorët ikën ashtu siç erdhën

SHKUNDEN FOLETË E YJEVE

Kjo ecje e ngathtë
Nuk do të më pengoj të mbërri
Deri te udha e premtuar
Ku përherë lindin psalmet e reja
Dhe vdesin ato të vjetra

Kjo është hera e parë në jetë
Që shikoj dritën
Përtej asaj dritës inkandeshente
Nga krahët e një korbi të bardhë
Zbresin dritat e shumëllojshme

Nga tejdukshmëria e tyre
Shkunden foletë e yjeve
Shkunden
Me miliona llojesh
Të shkëndijave vezulluese

Pas nesh diku prapa shpine
Shtrihet një copë zjarri
I cili shkëlqen si fjala
Nëpër ligjëratat e përbëra

Ne ecim drejtë një tjetër drite
Ecim dhe nuk ndalemi askund
Sepse askurrë nuk i përngjajmë
Ëndrrave tona të brishta

TROKITE NË SHPIRTIN E DRURIT

Të kujtohet kur shkelnim
Me shputat tona
Virgjërinë e yjeve endacak

Ishte ai mëngjes i hershëm
Kur vesa zuri të lëshohej
Mbi flokët e erës
Kurse nata përgatitej
Të ikte pas atyre maleve

Atë ditë asnjë engjëll
Nuk i përsëriste psalmet
Ishte një kor i çuditshëm
Mes nesh
Dëgjohej vetëm zëri i shiut imcak
Dëgjohej
Kah trokiste nëpër xhama
Si qukapiku i dehur
Trokiste në shpirtin e drurit

Ne asgjë nuk bëmë
As që mund të bënim diçka
Duart tona qëndronim të hutuara
Dhe të humbura mes mendimeve të fjetura

Ne pa dashje
I përngjanim qirinjve në shandan
Që rrinë duke u ndezur në heshtje
Ashtu dukeshin ëndrrat tona
Pa bunacë
Në shpirtin e detit të përgjumur
Dikur vonë kur i çelëm sytë
Fluturat veç kishin ikur

I ZGJATI DUART DREJT YJEVE

Mëngjeseve herët
Nga dritarja ime me xhama të thyer
I zgjati duart drejtë yjeve
I zgjati deri atje
Ku fillojnë
Dhe përfundojnë ëndrrat e mia

Me sy të mbyllur
Vrapojë rrugëve të ngushta
Të hapësirës së tejdukshme
Në asnjë meteor nuk marr thua
Vrapi im
Në shikim të parë është shumë i thjeshtë
I përngjanë duarve të erës

Sa herë që hasi nëpër pengesa
Prej yjeve më të largët kërkoj ndihmë
Kur mërzitem
E marr në sy dynjanë
Dhe vrapi im i përngjanë
Erës së brishtë
Që asnjëherë nuk i thyen këmbët

Prishtinë, 16 maj 2014

NJË MBRËMJE DURRSAKE ME POEZI

Shkundi problemet tua
Ashtu siç i shkundje në pranverë
Lulet nga fustani yt i virgjër
Nëpër korijet e adoleshencës së kujtimeve
Sa me mall ëndërroj mështeknën lakuriqe

Unë nuk doja shumë prej teje
Mua më mjaftonin
Vetëm ëndrrat tua
Dhe gurgullima e qeshjes së erës

Më mjafton kaltërsia e syve
Ku në pasqyrën e tyre
Mund t'i krihja
Flokët e mia të thinjura
Deri në amshim

Të lutem derisa vallëzon si shakullina
Shkunde fustanin e erës
Shkundi edhe zhgjëndrrat tua
Në sofrën
E kësaj mbrëmjeje Durrsake me poezi

KU PAS ÇDO GOTE TË DEHUR

Kjo ngjanë vetëm te ne
Ngjanë
Që të zvarritemi si ushejzat
E mallkimeve të hijeve
Ku mbi një plep të prerë
Qajnë drurët halor
Qajnë rrapet
Si rapsoditë e muzikave të trishtuara

Muret e ngjyrosura me të verdhë
Duken nga këndvështrimi i zogut
Si dete të vdekura
Kurse në lagjen tonë
Kur hingëllon Lumëbardhi
Thonë se kthehen sërish cerberët

Këto klithma nuk na lënë
As të vdesim
Përkundrazi si çdoherë
I ngjeshim radhët tona të shthurura
Nga ahengjet folklorike
Dhe me shpirtra prej patërshane
Sulemi mullinjve të erës

Bëhemi bedena të gjallë
Për atdheun e sfilitur
E kur i kapërcejmë këto tragjedi
Sërish shndërrohemi
Në disa hije anemike

Rrimë nëpër kafenetë e shthurura
Ku pas çdo gote të derdhur
Nga gjymi i pikëllimit
I vrasim miqtë tanë që nuk i vrau lufta

SHPRESAT E NJË REBELIMI

Në kohën e pakohë
Të një orari të zhurmshëm
Kotej mbrëmja e përgjumur

Dora e jote e brishtë
I përkundte yjet e stralltë
Dhe mendimet e meteorëve me bisht

Një tren i tredhur
Si një hamshor i zi nate
Galoponte nëpër zhgjëndrrën e xhadesë

Një kokë e prerë mustaqebardhë
Zgërdhihej
Burrërisht zgërdhihej
Me patkonjtë e kuajve

Nata i përngjante rrugës via Egnatia
Ishte një natë e gjatë
Që u fundos
Si lugati i sëmurë
Në shpirtin e xhadesë

Nata
E një tradhtie të pabesë
Arabaxhiu i verbër më nuk qante
Sytë e tij të kaltër
Kishin mbetur pa pikë loti

Nga syri i shterur i sterrës
Asgjë s’pikonte
Përpos yjeve që shkyçeshin
Si qirinjtë e sosur
Shkyçeshin deri në pambarim
Shpresat e një rebelimi

MË DUKET SE KËTYRE NJERËZVE

Eci i humbur në realitetin tim
Shoh njerëz të vegjël e të varfër
Rrugëve të mëdha
Me dëshira të vogla

Më duket se këtyre njerëzve
Asgjë nuk u duhet
Përpos një copë bukë
E cila u mungon në sofrën e përditshmërisë

Ata përgjumen nëpër stacione trenash
Zgjohen si këndesat e egër
Me nga një trastë në krah depërtojnë thellë
Në varfërinë e tyre të paskajshme
U përngjajnë strucëve të pa kokë

Po që se rrëkëllejnë ndokund
Ndonjë filxhan me kafe qyl
Së pari çfarë bëjnë
Është ta kthejnë filxhanin e kafesë
Mbi tabakanë e bardhë

Për çdo ditë i kthejnë filxhanët
Për ta shikuar drejtë në sy
Fatin e tyre fatkeq
Që është strukur në shpirtin
E kafesë farmak

Ky realitet i hidhur
Për çdo ditë po përsëritet
Nëpër rrugicat e lagjes sime
Po përsëritet
Si përditshmëria e jonë e trishtë

AI USHTAR

Ai ushtarë
Që po fle rrugëve
Dikur kishte një shtëpi
Një grua të bukur
Dhe dy fëmijë
Që i përngjanin selvisë

Një ditë
Si nga Ferri dolën cerberët
Ia dogjën çatinë
Ai ushtarë i bekuar
Sot përgjumet trotuareve
Dhe zgjohet si makthi
Nëpër faltore

Ai ushtar
Shpirtbardhë
Pa plaçkë e shtëpi
Sot bredhë rrugëve
Si një lubi

Dhe nuk ndalet dot
Së bredhuri
Duke e kërkuar
Nëpër Kosovën martire
Fëmijët e vrarë dhe gruan e tij

NËPËR XHEPAT E ATDHEUT

Ishin kohërat e liga
Na u deshtë të lindim për nesër
Dhe të vdesim heroikisht
Duke lindur pas vdekjes sonë

Nëpër xhepat e atdheut
I lëmë peng gjymtyrët
Kjo ishte e tëra
Çfarë mundëm të bëjmë dje

Dhe ana tjetër e medaljes
Se çfarë duhet të bëjmë sot
Të mos bëhemi gur varri nesër
Ose të këndojmë që të mos vdesim kurrë

Hymë nëpër trajtat e frikës
Dolëm ballëhapur para atdheut
I cili na priti
Jo ashtu siç i kënduam lirisë

Ja kjo është e tëra një pjesë
E pjesës së luftës sonë
E cila ngjanë pak me dashurinë
E pak me mallkimin e zogjve

Kur e mora pushkën në dorë
Thashë se hyra në udhën e mëkatit
Por jo atdheu është ajo zanë e mirë
Që na i lanë të gjitha mëkatet

Prishtinë,19 maj 2014

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi mësues nëpër fshatrat **Studençanit** të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime, kryesisht me poezi filloi të merret që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. I punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe të pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990*, nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. **“Bajraktarët e vatanit”,** poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 **“ Ky def prej hëne”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012

78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88**.”Sytë e gurtë të erës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89**.”Kur dehen perënditë”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. **“Fjetëm njëqind shekuj”** Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91**.”Krakëllimat e natës”,**Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. **“Ndjekësit e enigmave”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014

93. **“Atdheu i paçmuar**”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94**.”Psalm i harruar ”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”**Për që po bie moj kambanë**”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. **“Mbi flokët e ullukëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. **“Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e** Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98**. “Loti i gotës së dehur”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99**. ” Stina asnjanëse”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. **“Dëneste bashkë me erën”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. **“Druri i pikëlluar**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. **“ Një grusht dashuri”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. **“Lëreni zërin tim”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. **“Shi në qytetin tim”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
105. **. “Si trenat e verbër ” ,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. **“Zjarri i malli tim ”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

107 . "**Kur teshtinë era** " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
108. "**Mbi shpirtin e erës pagane** " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
109. **"Nëpër gjymtyrët e mjegullave " ,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
110**."Ajo nuk erdhi sonte**, Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
111**."Një hënë e zhveshur**",Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
112. **"Nëpër plasaritjet e mureve",**Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
113**."Mes telave me gjemba**", Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

Nëse më premton koha
cikli i parë

Gjithnjë duken në lëvizje 11
Kur nuk ka munguar dashuria 13
Nëse më premton koha 15
Asnjëherë nuk pata kohë 16
Në qenien e njeriut 17
Ato janë në gjendje 18
Që i përngjanë dashurisë 19
Herë janë të ëmbla e herë pelin 20
Për çatinë e madhe të atdheut 21
Thinisht buzëqeshte ardhacaku 22
Mbrëmë ishim shumë larg 23
Kurse dimrit plaken 25
Një ditë kanë aromë toke 26
Kush do t'i çel sonte portat e fjalëve 27
Unë nuk njoh gjuhë të huaja 28
Ishte një serenatë arkaike 29
Askush nuk gjendet në dhomë 30
Njerëzit nuk blejnë asgjë 31
Era zgërdhihej me shiringat 32
Qeni 33
Blejnë spinaq bajat 34
Nëpër ëndrra mjegullnajash 35

Mes telave gjembor
Cikli i parë

Më shumë bisedojnë me vetveten 39
Në fytyrat e zverdhura të drurëve 40
Trajtat e të gjitha pikave të shiut 41
Pantallonat e arnuara me mall 42
Shikon asgjënë në hapësirë 43
2. 44
Janë të mbyllur si papagajtë 45
Kishte një fytyrë asnjanëse 46
I mjelë mjegullat 47
Jetojnë me mendime të përziera 48
Ose mbrëmjeve të vona 50
Çdo mëngjes takoj një njeri me shpirt të gurtë 52
Dhe nga stërkalat e shiut të imtë 53
Asnjëherë nuk vjen dielli 54
Këpucët kishin marr udhë 55
Qante mbi një dunë pikëllimi 56
Përngjanin me fëmijët çamarrok 57
Për t'u takuar me jetën e zhveshur 59
Ikonat kanë dalë nga kornizat 60
Sërish nga imagjinata e epshit 61
I pimë gllënjkat e fundit të shiut 62
Pas ikjes së shirave 64
Përngjajnë me trenat e shurdhër 66
Për të ua marr këmbët si trofe lufte 67
Mes telave gjembor 69
Askujt nuk i pengojnë këto imazhe 70
Shkulnin dhembjen e vesës 71
Ta vëmë gishtin në kokë 72

Trokite në shpirtin e drurit
cikli i tretë

Ti ishe fjala e parë 75
Shkunden foletë e yjeve 76
Trokite në shpirtin e drurit 78
I zgjati duart drejtë yjeve 80
Një mbrëmje Durrsake me poezi 81
Ku pas çdo gote të dehur 82
Shpresat e një rebelimi 84
Më duket se këtyre njerëzve 86
Ai ushtar 88
Nëpër xhepat e atdheut 89

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Mes telave gjembor / Adem Zaplluzha. – Prishtinë: Trend, 2015. – 103 f. ; 21 cm.

[Shënime për autorin] : f. 91-100

ISBN 978-9951-694-06-3